



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri (JR) 5/2018
Datë 11.06.2018

Nr. vendimi (JR) 4
Datë 26.07.2018

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese, i përbërë nga:

Ardian Hajdari	Kryesues
Luan Daci	Relator
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, shqyrtoi sot në Tiranë, më datë 26.07.2018, ditë e enjte, ora 10:00, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, çështjen gjyqësore, që i përket:

ANKUES/ SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

BESIM TREZHNJEVA, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, përfaqësuar nga Avokati Fatmir Braka.

OBJEKTI I ANKIMIT:

Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datë 13.04.2018, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besim Trezhnjeva.

BAZA LIGJORE E ANKIMIT:

Nenet 63, 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

1. Me anë të vendimit nr. 14, datë 13.04.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Besim Trezhnjeva, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Kundër vendimit të Komisionit, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit me aktet nr. 3787 prot., datë 27.4.2018 dhe nr. 3787 prot., datë 28.5.2018, me objekt: “Ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin e tij në detyrë”, ankim të cilin subjekti i rivlerësimit e bazon në nenet 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), si dhe në nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012).
3. Subjekti i rivlerësimit, me ankimin e paraqitur, kërkon nga Kolegji i Posaçëm Apelimt që paraprakisht të vendosë që çështja të kalohet në seancë gjyqësore dhe të riçelet hetimi gjyqësor, ku të thirret një grup ekspertësh kontabilistë të cilët duhet të bëjnë një rivlerësim tërësisht të ri të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të për të gjithë periudhën e deklaramit, dhe përfundimisht të vendosë ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin në detyrë.
4. Ankuesi ka pretendimin se vendimi, objekt apelimi, është kontradiktor në përmbajtje, në interpretim të gabuar të ligjit, në deformim të koncepteve bazike të së drejtës civile, nuk është respektuar parimi i barazisë para ligjit dhe parimi i ligjshmërisë së procesit.
5. Sipas ankuesit, Komisioni ka ligjëruar mungesën e përfshirjes në të ardhurat e përgjithshme të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, sipas të cilit vetëm shumatorja tejkalon vlerën e pretenduar si të pajustificuar nga Komisioni.
6. Ankuesi pretendon në ankim se të ardhurat e realizuara dhe deklaruara edhe nga anëtarët madhorë të familjes së subjektit kanë qenë dy herë objekt i hetimit të thelluar nga ILDKPKI në vitet 2010-2015. Për gjithë këtë periudhë, deri në vitin 2013, së bashku me këtë të fundit ka një vlerësim përfundimtar ku nuk konstatohet asnjë shkelje e ligjit në deklaramin e pasurisë dhe justifikimin e burimeve financiare, dhe për këtë arsye duhet të konsiderohet “**gjë e gjykuar**” në kuptimin e të drejtave civile. Pra, sipas ankuesit, është në kundërshtim me ligjin konkluzioni i Komisionit për këtë periudhë, se subjekti i rivlerësimit ka diferenca të pajustificuara në pasurinë e tij.
7. Ankuesi lidhur me këtë vendimmarrje, objekt ankimi, pretendon së i është shkelur parimi i sigurisë juridike në përgjithësi dhe i gjësë së gjykuar në veçanti, pretendon se nuk është respektuar neni 4, par. 5 i ligjit nr. 84/2016, parimi i barazisë përpara ligjit dhe i procesit të rregullt ligjor.
8. Sipas ankuesit, vlera e vlerësuar si e pajustificuar nga ana e Komisionit, prej 20.133.368 (njëzet milionë e njëqind e tridhjetë e tre e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, rezulton të jetë dukshëm më pak vetëm se vlera e xhiruar nga Drejtoria e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor (DSKSH) në llogarinë e farmacisë {***} prej 28.792.968 lekë në periudhën 2001-2016, dhe se kjo vlerë nuk është përfshirë fare në llogaritjet direkte apo indirekte nga ana e Komisionit, fakt që konfirmohet nga konkluzionet e analizës financiare të shoqërisë tregtare audituese {***} SHPK të datës 31.03.2018. Pjesë e shumë diferencë 20.133.368 (njëzet milionë e njëqind e tridhjetë e tre e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, të pretenduar si të pajustificuar nga ana e Komisionit, është edhe kredia prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh që subjekti i rivlerësimit Besim Trezhnjeva ka marrë tek “Alpha Bank” SHA në datën 13.11.2008, e përdorur për të

blerë sipërfaqe banimi, konkretisht apartament me sipërfaqe 120.5 m², e regjistruar si pasuria nr. {***}, z.k. {***}, nr. regj. 58, Blv. {***}, ap. {***}, k. {***}.

9. Nuk ndodhemi para deklaramit të rremë dhe mungesës së burimeve financiare për shumën prej 50.000 euro, sipas ankuesit, përderisa subjekti i rivlerësimit Besim Trezhnjeva ka marrë kredi nga “Alpha Bank” dhe ka shoqëruar deklarin e tij me kontratën e kredisë. Sipas ankuesit, vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë tek “Alpha Bank” SHA me qëllim përfitimin e një kredie në mënyrë të paligjshme dhe nëpërmjet veprimeve fiktive, është tej kompetencave të parashikuara në ligjin nr. 84/2016 (*ultra vires*) pasi ka marrë në vlerësim ligjshmërinë (fiktivitetin) e një veprimi juridik të lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe një banke të nivelit të dytë, duke dhënë se ndodhemi para një veprimi juridik fiktiv, absolutisht të pavlefshëm. Pra, Komisioni në këtë rast ka marrë rolin e gjykatës sa i përket pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik dhe fiktivitetit të tij.
10. Në lidhje me vlerësimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur pasurinë në shumën 148.226 (njëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e njëzet e dy) lekë, llogari e vajzës së tij {***} pranë “Credins Bank”, ankuesi kundërshton se ai vlerësim nuk justifikohet nga faktet e evidentuara në procesin e hetimit administrativ. Përkundrazi sipas ankuesit, duke qenë llogaria bankare e fundvitit e vajzës së subjektit të rivlerësimit, është një pakujdesi njerëzore e rëndësisë minimale, nuk lexohet nga këto veprime një qëllim i qartë i fshehjes së pasurisë, pasi derdhja e pagës është e verifikueshme në çdo kohë dhe nuk paraqet ndikim në lidhje me gjithë volumin e pasurisë së deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit.
11. Konkluzioni i Komisionit, se nga ana e subjektit të rivlerësimit është bërë deklarin i rremë në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes, {***}, në shumën 22.500.000 lekë, ankuesi shprehet se është spektakolar dhe haptazi jologjik sepse nuk ka marrë në konsideratë raportin e auditit të pavarur, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, përderisa nuk është referuar te dokumentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, por është bazuar në praktikën dokumentare të mbledhur nga Komisioni në hetimin administrativ. Nisur nga ky arsytim i subjektit në f. 16 (ose f. 444 e dosjes), ai kërkon kryerjen e një akti ekspertimi nga trupi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, riçelje të hetimit për të thirrur një grup ekspertësh kontabilistë, të cilët duhet të bëjnë një vlerësim tërësor të situatës financiare të subjektit dhe të personave të lidhur me të.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, dëgjoi relatorin e çështjes, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

Rrethanat e faktit

12. Subjekti i rivlerësimit, është gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës dhe kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), dhe për këtë arsye i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me

përparësi shqyrtimi, bazuar në nenin 276, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016), i cili parashikon: “Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bën rivlerësimin e gjyqtarëve që kandidojnë”.

13. Pas caktimit me shortin e datës 30.11.2017 të trupit gjykues për shqyrtimin e kësaj çështjeje, caktimit me short të Relatorit të Çështjes, si dhe zgjedhjes me short ndërmjet anëtarëve të Kryesuesit të trupit gjykues, me vendimin e trupit gjykues të datës 6.12.2017, ka filluar hetimi administrativ për këtë subjekt.
14. Gjatë hetimit administrativ, mbështetur në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”, Komisioni ka administruar raportet nga institucionet kompetente në lidhje me vlerësimet e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Procedura administrative ka përfunduar me vendim përfundimtar vetëm për kriterin e pasurisë, duke mos u bazuar në dy kriteret e tjera, kjo, dhe për të cilat hetimi administrativ nuk është konsideruar i mbyllur, por i mjaftueshëm për disponimin përfundimtar nga Komisioni.
15. Në vijim të deklaratës së pasurisë me nr. indeksi 01614, datë 21.01.2017, bazuar në nenin 31-33 të ligjit nr. 84/2016 nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), është përgatitur Raporti i vlerësimit të pasurisë nr. 131/34 prot., datë 13.11.2017, dhe sipas këtij raporti të vlerësimit të pasurisë të përgatitur nga ILDKPKI, ka rezultuar se: “i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) subjekti ka kryer fshehje të pasurisë; iv) ka kryer deklarim të rremë; dhe v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave”.
16. Në përfundim të hetimeve të Komisionit, që filluan në datën 6.12.2017 dhe përfunduan në datën 19.3.2018, rezultuan si të dhëna dhe fakte, pasuri të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, deri në vitin 2003, si më poshtë vijnë: i) **shtëpi banimi** me sip. 71.6 m², nr. pas. {***}, z.k. {***}, vol. {***}, f. {***}, rr. “{***}”, pll. {***}, shk. {***}, k. {***}, ap. {***}, Tiranë, e blerë në vitin 2002, me kontratë shitje pasuri e patundshme nr. 1311 rep., nr. 318 kol., dt. 13.8.2002, para noterit {***}, nga shitësi vëllai {***}, me çmim 15400000 lekë, me burime kursimet familjare; ii) **shtëpi banimi**, me sip. 64 m², ndodhur në Tiranë, rr. {***}, pll. {***}, shk. {***}, k. {***}, ap. {***}, nr. pas. {***}, vol. {***}, f. {***}, z.k. {***}, çmimi i blerjes 3500000 lekë, në vitin 2003, adoptuar për farmaci në funksion të aktivitetit tregtar - financiar të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten {***}, mënyra e fitimit të pronësisë, kontratë shitje nr. 6706 rep., nr. 1657 kol. dt. 12.11.2003, para noterit {***}; iii) **autoveturë** tip Benz Mercedes {***}, vlera 320000 lekë, pa kontratë të administruar, deklaruar në vitin 2003. Pas përllogaritjeve të blerjes së pasurive të sipërpërmendura dhe pas analizës financiare deri në vitin 2003, rezulton se subjekti nuk justifikon burimet e ligjshme për këto pasuri, si dhe për të justifikuar kursimet dhe shpenzimet e krijuara gjatë këtyre viteve, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “5. Në përfundim të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së

përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit”.

17. Po kjo situatë ekonomiko-financiare e subjektit të rivlerësimit ka vijuar edhe në vitet e mëpasshme, për sa u përket burimeve, kursimeve dhe shpenzimeve.
18. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara ne vitin 2006, vit rivlerësimi, rezulton e blerë autovetura tip Benz Mercedes {***}, në vlerën 1.200.000 lekë. Pas analizës financiare, rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për kursimet dhe shpenzimet e krijuara në vitin 2006.
19. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara ne vitin 2007, subjekti nuk ka blerë pasuri, por pas studimit të situatës financiare, rezulton se nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar kursimet dhe shpenzimet.
20. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2008, konfirmohet se është blerë shtëpi banimi me sip. 143.74 m², nr. pas. {***} z. k. {***}, nr. regj. {***}, në adresën Blv. {***}, Tiranë, në vlerën 17.536.280 lekë. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë nga pakësimi i depozitës së bashkëshortes dhe kredi hipotekore pranë “Alpha Bank” në shumën 50.000 euro. Vërtetohet se kjo kredi nuk është përdorur për blerjen e kësaj pasurie (nr. pas. {***}), por ka shërbyer për likuidimin e sipërmarrësit {***} SHPK në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.10.2008, për blerje apartamenti në Durrës, prej 98 m², kontratë e cila është revokuar me deklaratën noteriale nr. 2686 rep., nr. 2285 kol., datë 18.12.2008. Gjatë analizës, rezulton se situata financiare e subjektit të rivlerësimit nuk është kthyer në gjendjen para hartimit të kontratës së sipërmarrjes dhe nuk ka dokument zyrtar për të provuar likuidimin e palëve përkatëse në gjendjen e mëparshme (kthimin e shumës prej 50.000 euro). Nga përlllogaritjet rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar kursimet, shpenzimet dhe pasuritë e vitit 2008.
21. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2010, nga përlllogaritja, subjekti nuk ka blerë pasuri, por, pas studimit të situatës financiare, rezulton se nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar kursimet dhe shpenzimet.
22. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2011, nga përlllogaritja, subjekti nuk ka blerë pasuri, por, pas studimit të situatës financiare, rezulton se nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar kursimet dhe shpenzimet.
23. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2012, nga përlllogaritja rezulton se subjekti ka blerë tokë 1920 m², nr. pas. {***}, nr. 6691 rep., nr. 1206 kol., datë 30.07.2012, Tiranë, me vlerë 879.360 lekë. Pas studimit të situatës financiare, rezulton se nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, kursimet dhe shpenzimet.
24. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2013, nga përlllogaritja rezulton se subjekti ka blerë automjet tip Benz Mercedes, kontratë nr. 3222 rep., nr. 3085 kol., datë

13.11.2013, me vlerë 520000 lekë. Pas studimit të situatës financiare, rezulton se nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, si dhe kursimet dhe shpenzimet.

25. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2014, nga përlllogaritja rezulton se subjekti ka blerë automjet tip Benz Mercedes me targa {***}, kontratë nr. 2603 rep., nr. 2518 kol., datë 1.10.2014, me vlerë 16000 euro, me burim krijim shitje e autoveturës së mëparshme dhe pakësim i depozitës së bashkëshortes. Pas studimit të situatës financiare, rezulton se nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, si dhe kursimet dhe shpenzimet.
26. Konkluzionet e verifikimit të burimeve, kursimeve dhe shpenzimeve lidhur me detyrimet financiare të subjektit për deklarimet vjetore të pasurisë, në deklarimin e pasurisë së rivlerësimit (*vetting*) subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes për periudhën 2003-2016 shumën prej 22.500.000 lekë. Pas studimit të dokumentacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për efekt të hetimit administrativ rezulton se subjekti ka deklaruar vetëm xhiron e aktivitetit të bashkëshortes së tij, farmaci, jo fitimin real të gjeneruar nga ky biznes, nga i cili rrjedhin detyrime financiare për t'u paguar për shkak të kësaj të ardhure. Ky detyrim fiskal ligjor nuk është përmbushur nga subjekti. Pas përlllogaritjes, vlera e fitimit të bashkëshortes së subjektit në aktivitetin e saj, për periudhën 2003-2016 është 12.844.341 lekë dhe jo shuma e deklaruar prej 22.500.000 lekësh. Në këto rrethana, në kuptim të dispozitave që citohen në vijim, ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në RSH", ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH", bazuar në kontratën e subjektit me fondin e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, bazuar në ligjin nr. 9928, datë 29.4.2014, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ky fakt i deklarimit të vlerave të rimbursimit si pjesë e xhiros së aktivitetit privat të zonjës {***}, person i lidhur me subjektin e rivlerësimit si bashkëshorte, e çon subjektin e rivlerësimit në faktin e paraqitjes së rimbursimit si e ardhur e ligjshme, ndërkohë që ligji e parashikon si xhiro të tatueshme, duke i ulur subjektit akumulimin dhe ndarjen nga fitimi. Ky deklarim i xhiros për efekt të fitimit nuk është i saktë, bazuar në nenin 33, pika 5, germa "a" dhe "c" ligjit nr. 84/2016, dhe çon në konkluzionin juridik se jemi para faktit të mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë e këtij subjekti dhe të personave të lidhur më të në shumën 20.133.368 lekë, fakt i njohur. Po për këtë shumë të pajustificuar konstatohet deklarim i rremë nga subjekti, parashikuar në nenin 33, pika 5, germa "ç" e ligjit nr. 84/2016.
27. Në deklarimin e pasurisë së rivlerësimit (*vetting*) ka deklarim të numrit të llogarisë, por ka pasaktësi në deklarimin e shumës. Subjektit të rivlerësimit në këtë deklaratë i rezulton e padeklaruar shuma prej 148.226 lekësh, shumë kjo që është e pasqyruar në llogarinë bankare pranë "Credins Bank", e cila përfaqëson pagën, që në kushtet e nenit 33, pika 5 e ligjit 84/2016 është konsideruar si fshehje e pasurisë. Subjekti pretendon në ankim se kjo e dhënë nuk duhej marrë në konsideratë për vendimmarrjen ndaj tij, pasi ajo vjen nga një neglizhencë e lehtë e vajzës së tij. Ai pretendon se llogaria bankare është legale dhe e verifikueshme dhe nuk ka qëllim fshehjen e pasurisë. Komisioni këtë fakt e vlerëson dhe e klasifikon si fshehje, edhe pse përfaqëson një shumë të pakonsiderueshme. Kolegji çmon se përcaktimi është i drejtë kur merret në konsideratë fakti i mosdeklarimit si detyrim ligjor, i klasifikuar nga ligji si fshehje.

Në vendimmarrje ka determinuar situata financiare shumëvjeçare me pasuri të pajustificuara ligjërisht nga subjekti i rivlerësimit.

28. Në verifikim të situatës së tij financiare, Komisioni ka vlerësuar se rezulton diferencë e pajustificuar mbi shumën 20.000.000 lekë, vlerë e cila nga analiza financiare konstatohet edhe nga Kolegji i Apelimit si paraqitje në mënyrë të pasaktë, përpjekje për fshehje të pasuritë në pronësi, deklaram të rremë dhe mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Konstatohet se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në kriterin e pasurisë dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.
29. Gjithashtu, gjatë hetimeve paraprake subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë tërësisht bashkëpunues me Komisionin gjatë komunikimit elektronik, sipas nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: “Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji”. Lidhur me pyetësonin e parë të dërguar me postë elektronike (*e-mail*) në adresë të subjektit në datën 20.12.2017, Komisioni është njoftuar në rrugë elektronike se *e-mail*-i është nisur në datën 20.12.2017, ora 4:36:48 PM, dhe është lexuar nga subjekti po në datën 20.12.2017, në orën 5:34:29 PM. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar se për pyetësonin e dërguar me *e-mail* në datën 20.12.2017 është vënë në dijeni me vonesë, fakt i cili nuk rezulton të jetë i vërtetë, sipas vendimit të Komisionit.
30. Nisur nga rezultatet e hetimit, trupi gjykues ka vlerësuar se kriteri i pasurisë është i mjaftueshëm për procesin e rivlerësimit të subjektit dhe disponimin me një element, referuar nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
31. Trupi gjykues i Komisionit, pasi ka marrë në shqyrtim rrethanat e faktit që kanë rezultuar gjatë hetimit paraprak, në seancë dëgjimore publike ka vlerësuar pretendimet dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit.
32. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka pasur gjendje rreth 2.500.000 lekë në vitin 1993, e cila nuk i është marrë në konsideratë gjatë analizës financiare nga Komisioni për periudhën 1994-2003, ky trup gjykues ka vlerësuar se është i pambështetur në dokumente dhe veç kësaj, nga deklarimi për vitin 2003, kur subjektit i ka lindur detyrimi për deklarim të pasurive, nuk rezulton që ai të ketë pasur dhe të ketë deklaruar kursime për të vërtetuar këtë likuiditet, deklarime të cilat do të shërbenin si provë sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”.
33. Në lidhje me pretendimin se vlerësimi i pasurive sipas deklarameve të tij ndër vite, deri në fund të vitit 2013 duhet të konsiderohet si gjë e gjykuar, trupi gjykues ka vlerësuar se është tërësisht i pabazuar në ligj, pasi Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
34. Në lidhje me pretendimin se kriter parësor për shkarkimin nga detyra është se subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ketë më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, Komisioni ka vlerësuar se dyfishi i pasurisë është një nga shkaqet ligjore për marrjen e masës disiplinore të

shkarkimit nga detyra, parashikuar nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, i cili sanksionon edhe katër raste të tjera për marrjen e kësaj mase.

35. Në lidhje me pretendimin se kredia e marrë në bankë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro nuk është deklarim i rremë dhe se nuk ndodhet përpara mungesës së burimeve financiare dhe se pa të drejtë Komisioni ka konkluduar për veprim juridik të pavlefshëm, trupi gjykues ka vlerësuar se në rastin e kontratës së sipërmarrjes subjekti ka deklaruar në përgjegjësinë e tij se kontrata e sipërmarrjes dhe deklarata noteriale për zgjidhjen e saj janë bërë fiktive, për të mundësuar marrjen e kredisë për blerjen e apartamentit, ndodhur në Bulevardin {***}, Tiranë dhe se është provuar me dokumente shkresore gjatë hetimit administrativ se kredia e marrë në shumën prej 50.000 eurosh nga “Alpha Bank” nuk është përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, siç ka deklaruar subjekti, por ka kaluar në llogarinë e {***} SHPK. Gjithashtu, trupi gjykues ka vijuar në vlerësimet e tij se Komisioni nuk ka kompetencë ligjore dhe nuk ka kryer gjatë hetimit administrativ paraprak asnjë veprim lidhur me vërtetimin e vlefshmërisë ose të pavlefshmërisë së kontratës së sipërmarrjes.
36. Në lidhje me pretendimin se shuma e fshehur në emër të vajzës, person i lidhur, në vlerën 148.226 (njëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë, përfaqëson të ardhurat neto nga paga prej punëdhënësit publik dhe se kjo është një shumë modeste, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë detyrimin të deklarojnë të ardhurat neto si burime të ligjshme dhe gjendjet e llogarive bankare deri në periudhën e deklarimit dhe në asnjë rast nuk është përmendur se këto të ardhura nuk janë nga burime të ligjshme dhe se mosdeklarimi i çfarëdolloj shume, konsiderohet nga ligji si fshehje pasurie, sipas nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
37. Lidhur me pretendimin për të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat si farmacistë, trupi gjykues ka vlerësuar se të ardhurat neto të bashkëshortes së subjektit, znj. {***}, nga aktiviteti privat si farmacistë, janë 12.844.341 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e treqind e dyzet e një) lekë, dhe jo në shumën e deklaruar prej 22.500.000 (njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë, duke i vlerësuar si të pabazuara në prova e në ligj pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat e bashkëshortes në raportin e auditit të pavarur, pasi këto të ardhura janë të padokumentuara dhe të padeklaruara sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe si të tilla nuk duhet të merren në konsideratë. Sipas ligjit të sipërpërmendur dhe nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhura të ligjshme janë të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.
38. Në seancën dëgjimore datë 11.04.2018, trupi gjykues vendosi refuzimin e kërkesës së përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit për caktimin e një eksperti ose grupi ekspertësh, me qëllim vlerësimin e pasurisë së subjektit, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit është njohur me rezultatet paraprake të hetimit dhe deri në ditën e seancës dëgjimore nuk ka asnjë fakt apo rrethanë të re që ka lidhje me të ardhurat e znj. {***} si farmacistë për periudhën 2003-2016 dhe se ky raport i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk është bazuar në asnjë dokument fakt apo rrethanë të re të ndryshme nga ato ku është bazuar Komisioni. Në këtë vendim vazhdohet me argumentin se Komisioni ka tagrin dhe kapacitetin e plotë që të bëjë vlerësimin mbi të ardhurat e tjera të subjektit dhe personave të lidhur, duke kryer një hetim të thellë administrativ sipas neneve 45, 49, 50 të ligjit nr. 84/2016.

39. Në përfundim të kësaj procedure administrative të kontrollit të pasurisë, trupi gjykues ka rezultuar: i) ka deklarime të pasakta dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën për *vetting* lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë nr. {***} (sot pasuria nr. {***}), në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit dhe në lidhje me likuiditetet në *cash* të deklaruara nga subjekti (neni 33, pikat 1 dhe 5 të ligjit 84/2016); ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në vlerën prej 20.133.368 lekë (neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016); iii) ka deklarim të rremë në lidhje me kredinë prej 50.000 euro të marrë nga “Alpha Bank”, si pjesë e çmimit të blerjes së pasurisë me nr. {***} (sot pasuria nr. {***}), pasi kjo nuk është vërtetuar gjatë hetimit administrativ, përkundrazi, është vërtetuar se kjo shumë ka kaluar në llogari të shoqërisë {***}SHPK (neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016); iv) ka deklarim të rremë në lidhje me të ardhurat e deklaruara të bashkëshortes {***} në shumën 22.500.000 lekë për periudhën 2003-2016, pasi është vërtetuar se këto të ardhura janë në shumën 12.844.341 lekë (neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016); v) ka mosdeklarim të shumës prej 148.226 lekë, llogari e vajzës {***} pranë “Credins Bank”, e cila edhe pse vlerësohet nga trupi gjykues si një shumë jo e konsiderueshme, parashikohet si fshehje pasurie nga neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016; vi) nuk vërtetohet të jetë paguar te shitësi, z. {***}, shuma prej 5.878.280 lekë, si pjesë e çmimit të shitjes së pasurisë me nr. {***} (sot pasuria nr. {***}); vii) ka mosdeklarim të shumës prej 75.000 euro të përfituar nga kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme, pasi kontrata e sipërmarrjes me nr. 2356 rep., nr. 1955/1 kol., datë 27.10.2008, është zgjidhur me deklaratën noteriale nr. 2686 rep., nr. 2285 kol.
40. Bazuar në këto rezultate, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se ky subjekt i rivlerësimit kalimtar ka bërë deklarime të pasakta (neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016), ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë në shumën prej 20.133.368 lekësh (neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016), fshehje pasurie (neni 33, pika 5/c e ligjit nr. 84/2016); deklarime të rreme (neni 33, pika 5/ç e ligjit nr. 84/2016), dhe bazuar në këto konkluzione si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka deklarime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe atij duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

Vlerësimi i Kolegjit të Apelimit

41. Për sa më sipër gjykoi çështjen në tërësi, Kolegji i Apelimit në dhomë këshillimi dhe mbi bazë dokumentesh konstatoi dhe çmoi sa më poshtë.
42. Juridiksioni i rivlerësimit dhe kompetencat e institucioneve të ngritura posaçërisht bazohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, sipas së cilës: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese”, si dhe në nenin 5 (Institucionet e rivlerësimit), pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: “1) Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit

ndërkombëtarë. 2) Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit [...]”. Bazuar në këto përcaktime, çështja e paraqitur i përket juridiksionit të rivlerësimit, kompetent për të cilin është Kolegji i Apelit.

43. Ankuesi legjitimohet në aspektin kohor bazuar në nenin 63 (paraqitja e ankimit), pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apeliteve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”, pasi ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
44. Vlerësimin tërësor të procedurave për kriterin e pasurisë, Kolegji i Apelit e çmon të lidhur me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të së cilës duhet të arrihet në përfundimet nëse: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
45. Kolegji i Apelit vlerëson se vendimi nr. 14, datë 13.04.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor dhe në zbatim të ligjit, pikërisht në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: [...] Kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të këtij ligji”, si dhe në zbatim të nenit 58, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton: “1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: [...] c) shkarkimin nga detyra”, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar hetimit për shkak të këtij ligji, ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, duke rezultuar me pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, dhe për këtë shkak u disponua me vendim për shkarkimin e tij nga detyra. Kjo masë disiplinore është vendosur në kushtet dhe rrethanat e nenit 33, pika 5, gjerat “b”, “c”, “ç” të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: “5. Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit”.
46. Kërkimet në ankimin e subjektit të rivlerësimit të paraqitura me aktet nr. 3787 prot., datë 27.04.2018 dhe nr. 3787 prot., datë 28.05.2018, me objekt ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, Kolegji i Apelit për arsyet e detajuara më poshtë i vlerëson të pabazuara në ligj dhe në prova, dhe si të tillë të pacenueshëm vendimin objekt ankimi nr. 14, datë 13.04.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
47. Vendimin e Komisionit në funksion të ankimit të paraqitur, Kolegji i Apelit e vlerëson të drejtë si në thelb, ashtu edhe në procedurë, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me doktrinën e Gjykatës Kushtetuese dhe me qëllimin kushtetues, që të garantohet funksionimi i shtetit të së

drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

48. Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, përbën një juridiksion të posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit. Këto garanci gjejnë mbështetje brenda parimeve të procesit të rregullt për t'u dëgjuar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe sanksionimit të lirive themelore, kufizime të cilave mund të vendosen për një interes publik dhe pa cenuar thelbin.
49. Anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, të caktuar me short, kryesisht kanë deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, paanësia e të cilëve nuk është vënë në diskutim as nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe për këtë arsye është garantuar gjykimi nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, bazuar në nenin 6, pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përcakton: “1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht [...]”, dhe në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës, e cila përcakton: “2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.
50. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nga Komisioni, me vendimin objekt ankimi ndaj subjektit të rivlerësimit, çmohet nga Kolegji si i drejtë, me mbështetje ligjore në nenin 58, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, në referencë të nenit 61, pika 3 e po këtij ligji në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, rrethanë kjo e parashikuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.
51. Për sa i përket shqyrtimit të çështjes, procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji nr. 49/2012, nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55.
52. Si rregull bazë i kompetencës funksionale të Kolegjit të Apelit është papranueshmëria për të paraqitur prova të reja në gjykim, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili përcakton: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.
53. Gjithashtu, si rregull, gjykimi para Kolegjit të Apelit zhvillohet në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, i cili përcakton: “1. Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. 2. Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit

të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. 3. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor”, përveç rasteve përjashtimore të përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, e cila përcakton: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë”.

54. Kolegji i Apelimit vlerësoi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, pasi nuk e gjeti të bazuar në dispozitat e mësipërme pretendimin dhe kërkimin e ankuesit për kalim të çështjes në seancë gjyqësore publike, sepse vlerësoi se gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe nuk vërehen shkelje të rënda procedurale, dhe për këto arsye çmon se nuk është i nevojshëm debati gjyqësor dhe marrja e provave të reja.
55. Në ankimin e paraqitur ankuesi ka kërkuar përsëritjen e pjesshme të gjykimit dhe kryerjen e një ekspertimi në fushën e kontabilitetit. Kërkesa për kryerjen e ekspertimit në fushën e kontabilitetit është ngritur edhe para Komisionit, por është rrëzuar duke e çmuar si provë të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se: “Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme [...]”.
56. Për sa i përket objektit të shqyrtimit, Kolegji i Apelimit thekson se objekti i procesit të rivlerësimit kalimtar është i përbërë nga 3 (tri) procedura të ndryshme, ku përfshihen kontrolli i pasurisë, i figurës dhe i aftësive profesionale të sanksionuara nga neni 4 i Aneksit të Kushtetutës dhe të parashikuara nga neni 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: “1. Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kritereve: a) vlerësimi i pasurisë; b) kontrolli i figurës; dhe c) vlerësimi i aftësive profesionale”. Procedurat e kontrollit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale fillojnë njëkohësisht dhe rendin paralelisht duke i shërbyer të njëjtit qëllim “që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”, në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 84/2016.
57. Kolegji i Apelimit e vlerëson të pabazuar pretendimin se trupi gjyqësor i Komisionit ka shkelur parimin e kontradiktoritetit për shkak se Komisioni i ka dhënë përgjigje rregullisht pretendimeve të ngritura dhe duke ju referuar edhe raportit të ekspertit të pavarur, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në fazën e hetimeve paraprake dhe gjatë shqyrtimi në seancë dëgjimore.
58. Për sa i përket pretendimit për shkeljen e parimit të gjësë së gjykuar, Kolegji i Apelimit vlerëson se ajo është e pabazuar në ligj, sepse të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, sikurse rasti objekt gjykimi. Pra, ka kryer rivlerësim për elementin pasuri ndaj subjektit të rivlerësimit të mësipërm, i autorizuar tashmë nga një ligj i posaçëm me një metodologji dhe procedurë krejt të ndryshme nga sa pretendon ankuesi, i cili është subjekt i një ligji të tillë, si një ligj me qëllim dhe funksion krejt të ndryshëm nga ata të mëparshmit. Rivlerësimi i tij për shkak të ligjit nr.

84/2016, aplikohet dhe kryhet vetëm një herë dhe definohet nga një institucion tjetër, siç është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili ka autoritetin dhe kompetencën për definimin e vendimmarrjes ndaj subjekteve të rivlerësimit.

59. Mënyra e përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar në tërësi dhe i procedurave të kontrollit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale në veçanti, përcaktohen nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e cila ndërmjet të tjerave përcakton edhe se vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Pra, në respektim të qartë të kësaj dispozite ligjore, Komisioni ka disponuar në përfundim të procesit të hetimit administrativ, bazuar në një kriter për këtë subjekt dhe pikërisht në kriterin e pasurisë që autorizohet nga neni 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe që nuk ka asnjë dispozitë ndaluese në këtë ligj që të pengojë disponimin vetëm për një element në vlerësimin tërësor të subjektit. Pikërisht për këtë shkak thelbësor, madje në respektim të plotë të urdhërimeve dhe nominimeve që përcakton neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe në referim të nenit 33, pika 5, gjerat “a”, “b”, “c”, “ç” të ligjit 84/2016, ky subjekt është shkarkuar nga detyra si një masë disiplinore që rrjedh pikërisht nga këto urdhërime dhe sanksione ligjore. Është konstatuar drejt nga Komisioni se ka bërë deklaramë të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Pra, ky vendim i Komisionit është qartësisht i bazuar dhe në frymën e dispozitave kushtetuese, siç janë neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.
60. Për rastet e shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk është parakusht për vendimmarrje përfundimi i të tria procedurave, pasi vendimi mund të merret edhe kur plotësohen veçmas shkaqet në vijim: i) kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të; ii) kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës; iii) kur rezulton se ka bërë deklaramë të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji; iv) kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.
61. Në çdo rast, procesi i rivlerësimit, në bazë të ligjit, fillon njëkohësisht për të tria kriteret e vlerësimit, por vendimi përfundimtar mund të bazohet edhe në një prej kriterëve, sikurse në rastin në gjykim, që ka përfunduar vetëm për kriterin e pasurisë. Për procedurat e papërfunduara, për të cilat nuk ka një përcaktim të posaçëm, Komisioni në rastin objekt gjykimi, ka proceduar me disponim prej saj vetëm për një element, atë të pasurisë, duke respektuar në mënyrë korrekte urdhërimet ligjore të mësipërme.
62. Kolegji i Apelit vlerëson se dokumentet e dosjes vijnë nga burime të njohura, provat janë të besueshme dhe ato janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, dhe nuk janë rastet e nevojshmërisë për konstatimin e drejtë të gjendjes faktike apo në mënyrë të plotë dhe të saktë, duke respektuar në mënyrë korrekte urdhërimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e

tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.

63. Rezulton nga materialet e dosjes se, procedura e rivlerësimit ka filluar rregullisht me anë të deklaratës së pasurisë paraqitur në ILDKPKI në datën 27.01.2017, në bazë të së cilës kjo e fundit ka përgatitur raportin e vlerësimit të pasurisë, datë 13.11.2017, në përfundim të të cilit ka arritur në përfundimin se ka deklarim të rremë, mungesë burimi financiar.
64. Për sa i përket pretendimit se nuk është marrë në konsideratë gjendja rreth 2500000 lekë deri në vitin 1993, Kolegji i Apelit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova të besueshme për të justifikuar shumën e pretenduar.
65. Vërtetohen kushtet e deklarimit të pasaktë gjatë viteve në deklaratat e pasurisë për llogaritë bankare dhe lëvizjet në to, të mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë ndër vite, si dhe depozitat dhe gjendjen *cash* të krijuar.
66. Procedura e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe, nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit, përveç kur subjekti paraqet prova që provojnë të kundërtën. Sanksionimi kushtetues, në mënyrë autentike përkufizon konceptin e pasurive të ligjshme, pasuri të cilat janë “të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.
67. Në kundërshtim me dispozitën kushtetuese subjekti i rivlerësimit përpiket të paraqesë në mënyrë të pasaktë qarkullimin e viteve ushtrimore të personit të lidhur, i cili është i ndryshëm nga pasuria (e ardhura) e ligjshme dhe për këtë arsye zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
68. Subjekti i rivlerësimit ka një pasuri dukshëm më të madhe se pasuria e ligjshme, e cila nuk e arrin dyfishin e kësaj të fundit, por nga vlerësimi tërësor i procedurave të kontrollit të pasurisë, deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
69. Gjithashtu, për arsye se të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme, është i pabazuar pretendimi se është tej kompetencave të Komisionit analiza e fakteve që mund të çojnë në fiktivitetin e veprimit juridik. Në këtë rast, Komisioni ka argumentuar motivimin e subjektit të rivlerësimit që ka marrë kredi për të blerë pasuri të ndryshme me destinacionin përfundimtar të kredisë së disbursuar.

Konkluzioni i Kolegjit të Apelit

70. Procesi i hetimit administrativ të këtij subjekti rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, dhe me disponim vetëm për një element, atë të pasurisë, ka qenë tërësisht i ligjshëm nga Komisioni

duke respektuar elementet e procesit të rregullt ligjor, detyrues për të, në bazë të nenit 179/b, pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke respektuar si parimet e këtij procesi të rregullt edhe të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, lidhur kjo me të drejtën për të dëgjuar dhe gjykuar drejtësisht pranë Komisionit, të njohjes me dosjen, të drejtën për të paraqitur prova, kjo e materializuar edhe me një akt auditi të paraqitur prej tij, e drejta e dëgjimit në seancë publike, e komentit dhe e kundërshtimit të provave dhe të fakteve që ai vetë ka deklaruar në aktet e depozituara pranë Komisionit për shkak të këtij procesi.

71. I është garantuar e drejta e dëgjimit në seancë publike, e mbrojtjes nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit. Është vënë në dijeni për seancën gjyqësore duke e bërë me dije se ai në këtë proces ka pasur të drejtë për të paraqitur parashtresë për shkaqet e ankimit ose për kërkime të tjera. Pra, procesi rezulton tërësisht i rregullt ligjërisht.
72. Për shqyrtimin e vendimit Kolegji i Apelit, pasi u njoh me të gjitha aktet objekt hetimi nga Komisioni, procedoi për gjykim në dhomën e këshillimit, i autorizuar nga neni 65 i ligjit nr. 84/2016, i cili delegon përputhshmërinë e procesit të gjyqimit në Kolegjin e Apelit mbi bazën e rregullave të parashikuara në nenet 47, 48, 49, 51, 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Pas analizës së provave dhe fakteve të rezultuara, lidhur këto me pretendimet e ankimit dhe me përmbajtjen e vendimit nr. 14, datë 13.04.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kolegji i Apelit konstatoi dhe çmoi se vendimi nr. 14, datë 13.04.2018, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi në bazë të nenit 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
73. Duke qenë se këto dokumente përbëjnë prova të ligjshme dhe të përdorshme nga Komisioni, në kuptim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nga dokumentet e marra nga burime të njohura dhe bazuar në prova të besueshme që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera po sipas kësaj dispozite, Kolegji i Apelit çmon se vendimi nr. 14 i Komisionit, datë 13.04.2018, është rezultat i një analize dhe provueshmërisë së plotë të fakteve juridike në atribuim të subjektit të rivlerësimit që e kanë çuar këtë Komision në një vendimmarrje të bazuar qartësisht në parashikimet dhe urdhërimet e nenit 33, pika 5, gjerat “a”, “b”, “c”, “ç” të ligjit nr. 84/2016.
74. Shkaqet definitive për të cilat edhe Kolegji i Apelit çmon se vendimi i Komisionit është i drejtë, lidhen me këto fakte në atribuim të këtij subjekti të rivlerësimit: i) ka deklarime të pasakta (neni 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016); ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në shumën prej 20.133.368 lekësh (neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016); iii) është kryer fshehje pasurie (neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016); ii) ka deklarime të rreme (neni 33, pika 5, pika “ç” e ligjit nr. 84/2016), dhe bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji konkludon se ky subjekt rivlerësimi, z. Besim Trezhnjeva, ka deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë (neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016) dhe ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë (neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016), dhe për këto me të drejtë Komisioni ka vendosur t’i jepet si masë disiplinore shkarkimi nga detyra. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra i jepet subjektit kur rezulton se ka bërë deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe kur subjekti nuk ka

shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij, për të cilat duhet të paguheshin detyrimet tatimore, urdhërim i nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

pas raportit dhe rekomandimit të Relatorit të Çështjes, trupi gjykues, mbështetur në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 14, datë 13.04.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Besim Trezhnjeva.
2. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 26.07.2018.

RELATOR I ÇËSHTJES

Luan DACI
nënshkrimi

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES

Ardian HAJDARI
nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA
nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO
nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, po parashtroj më poshtë argumentet e një arsytimi paralel me arsyetimin e vendimit nr. 4, datë 26.07.2018, (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit Besim Trezhnjeva, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Që në fillim më duhet të nënvizoj faktin se kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 14, datë 13.04.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besim Trezhnjeva.
3. Gjithashtu mbështes dhe jam dakord me të gjitha argumentet dhe shkaqet për të cilat është vendosur ky shkarkim që janë përdorur dhe pranuar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në arsytimin e vendimit.
4. Kam ndarë mendim të ndryshëm me shumicën e trupës gjyqësore dhe kam votuar kundër njërës prej shkaqeve të shkarkimit për subjektin, të renditur në vendimin nr. 14, datë 13.04.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, shkak i cili është mbështetur edhe nga vendimi i shumicës së trupës gjyqësore në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.
5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konsideruar ndër të tjera si njërin prej shkaqeve të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit edhe fshehjen e pasurisë, sipas nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, element që plotëson kushtin e deklaramentit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
6. Ky shkak ligjor lidhet sipas Komisionit dhe me faktin e mosdeklarimit prej personit të lidhur, vajzës së subjektit {***}, në deklaratën *vetting*, të shumës prej 148.226 lekë gjendje në llogarinë e pagës së saj.
7. Komisioni ka konkluduar që pavarësisht se shuma nuk është e konsiderueshme, ky fakt parashikohet si fshehje pasurie nga neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
8. Nga shqyrtimi i akteve, nga shkresa e lëshuar prej “Credins Bank” me nr. 61431/11, datë 27.12.2017, e administruar prej Komisionit, rezulton se kjo llogari dhe gjendja financiare e saj janë të prejardhura nga paga e personit të lidhur dhe e kredituar vetëm nëpërmjet burimit të të ardhurave që lidhet me marrëdhënien e punës së personit të lidhur në Qendrën Shëndetësore {***}. Në këtë kuptim, personi i lidhur provon burimin e ligjshëm të kësaj pasurie në formën e likuiditetit dhe për këtë element Komisioni nuk ka ngritur dyshime, por edhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit e pranon të vërtetuar burimin e ligjshëm të kësaj të ardhure, në paragrafin nr. 36 të arsytimit të vendimit.
9. Në vijim të këtij arsytimi, tek i cili nuk ka diskutime për burimin e ligjshëm të kësaj pasurie (likuiditet në shumën prej 148.226 lekë), vlerësoj se Komisioni duhej të kishte analizuar në këndvështrim të kësaj rrethane elementet e domosdoshme që ligji kërkon për të konkluduar për fshehjen e pasurisë, si një shkak që passjell vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
10. Neni 61, paragrafi 1, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 parashikon:
“Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste:
[...]

3. Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.”
11. Ndërkohë që neni 33, paragrafi 5, germa “c” e ligjit parashikon:
“5. Në përfundim të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se:
[...]
c) është kryer fshehje e pasurisë”.
12. Të dyja këto dispozita ligjore që sanksionojnë fshehjen e pasurisë si një nga shkaqet e shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, duhen parë të lidhura e në zbatim të parimit kushtetues të sanksionuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.
13. Në analizë të këtyre normave, shkakun “fshehje pasurie” i parashikuar në parim nga norma kushtetuese dhe i zbërthyer nga dispozita e ligjit, që të ekzistojë si i tillë dhe të shërbejë për të shkarkuar subjektin nga detyra, duhet të plotësojë njëkohësisht këto elemente:
14. Së pari, të provohet mosdeklarimi i pasurisë apo interesa të cilat gëzohen prej subjektit apo personave të lidhur.
15. Së dyti, të provohet fakti se subjekti është “përpjekur të fshehë” këto pasuri duke mos i deklaruar ato, në përputhje me parashikimin kushtetues.
16. Vlerësoj se elementi subjektiv i qëllimit për të fshehur pasurinë është një element pa të cilin nuk mund të konstatohet se ekziston shkakun i fshehjes së pasurisë në kuptim të dispozitave të sipërcituara. Në rast se do të pranohet të kundërtën, çdo pasaktësi në deklaratën *vetting* do të sillte automatikisht shkarkimin nga detyra, ndërkohë që parashikimi kushtetues e ka lidhur prezencën e pasaktësive me përpjekjet për të fshehur pasurinë, pra me një sjellje të subjektit që tregon pikërisht këtë qëllim. Të njëjtën frymë ka edhe shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84 /2016 kur parashikon sanksionet për mosplotësim të saktë të deklaratës.
17. Sipas këtij shënimi në formular parashikohet: “Mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit *Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”.
18. Pikërisht përdorimi i fjalës “mund” përjashton shkarkimin automatikisht të subjektit për çdo pasaktësi në deklaratë, dhe i vendos organet e rivlerësimit para detyrimit për të analizuar në mënyrë diskrecionale sjelljen e subjektit dhe të gjitha rrethanat që lidhen me pasaktësinë, për të konkluduar nëse jemi para një veprimtarie të qëllimshme për të fshehur pasuri apo para një pasaktësie në plotësimin e deklaratës *vetting*.
19. Në rastin objekt shqyrtimi vlerësoj se sjellja e personit të lidhur për mosdeklarimin e shumës prej 148.226 lekësh në gjendjen e saj të llogarisë së pagës, për sa kohë që është pranuar si nga Komisioni, edhe nga Kolegji se: a) burimi i këtyre të ardhurave është marrëdhënia e punës si mjeke; b) është një burim i deklaruar prej saj; c) është deklaruar e ardhura në total e përfituar prej këtij burimi, në shifrën prej 500.086 lekësh; ç) shuma

e padeklaruar është një pjesë përbërëse e shumës totale të deklaruar, nuk është sjellje e tillë që të krijojë bindjen se mosdeklarimi ka ndonjë qëllim për të fshehur pasuri.

20. Në kuptimin e normës kushtetuese, çmoj se ky mosdeklarim përbën një pasaktësi në plotësimin e deklaratës *vetting* prej personit të lidhur {***} që nuk mundet të përbëjë rastin e fshehjes së pasurisë, për të gjitha rrethanat që u arsyetuan më lart.
21. Për pasojë, në mbështetje të këtij arsytimi, i jam bashkuar arsytimit të shumicës për të gjitha elementet e tjera të vendimit, duke përjashtuar këtë, por që gjithsesi nuk cenon votën time për të lënë në fuqi vendimin nr. 14, datë 13.04.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Rezarta Schuetz, nuk bie dakord me shumicën lidhur me konstatimin e fshehjes nga ana e subjektit të rivlerësimit të shumës prej 148.226 lekë, të cilat i përkasin llogarisë së pagës së vajzës madhore të subjektit të rivlerësimit Besim Trezhnjeva pranë “Credins Bank”. Për sa kohë prejardhja e likuiditeteve dhe ligjshmëria e tyre nuk vihen në diskutim dhe nuk bëhet fjalë për fshehje likuiditetesh me natyrë të panjohur, Kolegji i Posaçëm i Apelit mund t’i qëndronte këndvështrimit ligjor civil. Sipas këtij të fundit, të ardhura të fshehura janë ato të cilat qëllimisht nuk tregohen. Fshehja, në këtë kuptim, prezumon parandalimin e zbulimit të pasurisë ose të të ardhurave ose të heshtjes mbi ekzistencën e të ardhurave¹. Në këtë dritë, fakti që subjekti nuk ka deklaruar ekzistencën e një llogarie, e cila ishte lehtësisht dhe relativisht shpejt e verifikueshme, sugjeron mungesën e arsyeve që mbështesin “përpjekjen për të fshehur” sipas nenit D, pika 4 e Kushtetutës, pasi duhet përjashtuar mundësia objektive që subjekti të ketë pasur pritshmëri që ekzistenca e kësaj llogarie do të fshihej pa pasoja për të gjatë një procesi kontrolli të detajuar si ai i procesit të rivlerësimit. Ndërsa shuma për të cilën flitet është e parëndësishme, veprimi konkret i subjektit të rivlerësimit në rrethanat në fjalë – rroga e vajzës madhore në një shumë e cila krahasuar me likuiditetet e tjera të cilat subjektit i janë përlllogaritur si të pajustificuara bindshëm – është pothuaj e papërfillshme dhe ligjshmëria e burimit përtej çdo debati, Kolegji mund ta kishte prezumuar si rezultat të një gabimi njerëzor, duke konfirmuar konstatimet e tjera të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me shkeljet e nenit 33, pika 5, germa “a”, “b”, “ç” dhe të nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
2. Sa i përket gjetjes së deklaramit të rremë sipas nenit 33, pika 5, germa “ç” ligjit nr. 84/2016.
(referuar kredisë së marrë nga “Alpha Bank”), parashtroj mendimin tim si më poshtë:
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar edhe në pohimin e subjektit të rivlerësimit, është ndodhur përpara konstatimit të një kontrate kredie fiktive të lidhur mes të parit dhe një biznesi privat (“Alpha Bank”) në Durrës. Është përtej diskutimit që shuma prej 50 mijë eurosh përfituar nga subjekti nuk është përdorur për qëllimin mbi të cilin bazohet kontrata e kredisë me “Alpha Bank”. Kjo shumë është përdorur për të financuar një apartament në Durrës. Nga dosja nuk rezulton që banka të ketë qenë e informuar për këtë përdorim të huas përtej projektit thelb i kontratës. Përkundrajt pretendimit në të kundërtën nga subjekti, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit thekson se nuk ka bërë asnjë veprim hetimi paraprak lidhur me vlefshmërinë e kontratës së sipërmarrjes. Subjekti, nga ana tjetër, kundërargumentoi, përveç të tjerash, edhe në seancën dëgjimore publike më 11 prill 2018 se Komisioni ka dalë jashtë tagrave të vet, pasi nuk ka të drejtë të disponojë mbi lirinë kontraktuale të tij si individ privat me një biznes, siç është në këtë rast banka huadhënëse. Në fund të vlerësimit, Komisioni konstaton vetëm deklaramit të rremë lidhur me kredinë sipas nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016. Në dispozitiv, Komisioni ka gjetur se subjekti i rivlerësimit shkarkohet nga

¹ *United States v. Schireson*

detyra pasi janë gjetur të vërtetuara kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 5, respektivisht deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Mendoj se Komisioni në vendimin e arsyetuar kishte mundësi të shtjellonte përse kontrata fiktive e lidhur nga subjekti me një person juridik privat sugjeron një sjellje përtej standardeve etike. Një kontratë fiktive e këtij karakteri cenon besimin e publikut të SISTEMI I DREJTËSISË.

4. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Edhe sipas Kodit të Etikës së Gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë:
5. “Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor, ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore.”²
6. Në rrethanat faktike në diskutim, Komisioni mund të kishte argumentuar bindshëm efektin mbi perceptimin publik të integritetit të një gjykatësi, në një kontratë qëllimisht fiktive kredie me një bankë në degën e qytetit ku ai edhe shërben si gjyqtar i një niveli të lartë. Minimalisht, deklarata të rreme të këtij karakteri mund të përbëjnë shkelje etike. Në sferën publike dhe në marrëdhëniet private të biznesit, sidomos ato të kredidhënies, të cilat presupozojnë që banka kredidhënëse është e mirinformuar për pozicionin e punës dhe të ardhurat mujore të kredimarrësve, është e pamundur të ndahet individi nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit me qendër në po atë qytet. Pikërisht në konstatimin e kësaj shkeljeje në dukje të etikës, Komisioni duhet të shtjellonte zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Jeta personale e gjyqtarëve, sjellja e tyre jashtëgjyqësore, është po aq e rëndësishme sa ajo në kontekstin profesional. Standarde të sjelljes etike të gjyqtarëve janë shtjelluar shterueshëm dhe vazhdojnë të shtjellohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), si dhe organet e qeverisjes së gjyqësorit në shumicën e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mes tyre, Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore³, referuar si kodi më i ri dhe autoritar i etikës gjyqësore, lidhur me sjelljen jashtëgjyqësore, zbatojnë qasjen sipas së cilës: “Në këto raste rekomandohet të zbatohet testi i vëzhgimit të sjelljes [jashtëgjyqësore] nga këndvështrimi i një individi të arsyeshëm, të paanshëm dhe të mirinformuar, më konkretisht: *Si do të perceptohet një sjellje e caktuar nga një individ i arsyeshëm, i paanshëm dhe i mirinformuar i shoqërisë dhe a e zvogëlon ky perceptim respektin për vetë gjyqtarin apo gjithë gjyqësorin?*”⁴ Siç shtjellon Komentari i Parimeve të Bangalores: “Ka më pak rëndësi se çfarë veprimesh ka kryer një gjyqtar, sesa çfarë mendojnë të tjerët që mund të bëjë ose ka bërë⁵”, qasje kjo e ngjashme me “teorinë e dukjes”, shtjelluar nga jurisprudenca e GJEDNJ lidhur me paanësinë. Standardet e etikës, sipas kësaj të fundit, zbatohen edhe jashtë gjykatës, përfshijnë jetën private dhe kërkojnë që gjyqtarët të sillen me integritet dhe në një mënyrë të denjë për detyrën.⁶ Për sa më sipër, pavarësisht dhe pa diskutuar natyrën private të kontratës mes subjektit dhe bankës, sjellja e vetëpranuar nga subjekti i

² Rregulli 13, http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf

³ <http://www.unodc.org/>

⁴ Për më tepër, Komentari i Parimeve të Bangalores <http://www.unodc.org>

⁵ https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_principles_of_Judicial_Conduct.pdf

⁶ GJEDNJ në Vogt, Kurtulmuş dhe Özpınar.

rivlerësimit përbën shkak për të gjetur që ky subjekt ka cenuar besimin e publikut te drejtësia dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet trajnimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit 84/2016.

GJYQTARE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi